

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19, paragrafi (1), pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrimin të dorëzuar nga Austroterm GmbH, me seli në Peter Schmid-Gase 1, 7423, Pinkafeld, Austri, përmes Andrea Lazarevska, avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 15.07.2024, nxjerr këtë

AKTVENDIM

Vërteton se përqendrimi, me të cilin Austroterm GmbH, me seli në Peter Schmid-Gase 1, 7423, Pinkafeld, Austri, fiton mjete të caktuara që i përkasin aktivitetit të izolimit (d.m.th. operimi me polistiren të zgjeruar) të Bruça Gesellschaft m.b.H., me seli në Rustershtrase 33, 3451, Mishelhausen, Austri, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 18.06.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua një njoftim për përqendrim nga Austroterm GmbH, me seli në Peter Schmid-Gase 1, 7423, Pinkafeld, Austri, me të cilin Austroterm GmbH fiton mjete të caktuara që i përkasin aktivitetit të izolimit (d.m.th. operimi me polistiren të zgjeruar) të Bruça Gesellschaft mbH, me seli në Rustershtrase 33, 3451, Mishelhausen, Austri.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit që nga dita e pranimit të tij dhe, bazuar në të dhënat e dorëzuara në njoftim dhe shtojcat përkatëse, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet kryesore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Austroterm GmbH është kryesisht aktive në prodhimin dhe shitjen e materialeve izolimi të bëra nga polistireni i zgjeruar ("EPS") dhe polistireni i ekstruduar (XPS), të cilat përdoren si materiale për izolimin e ndërtesave, por me fusha të ndryshme aplikimi. Portofoli i produkteve të Austroterm GmbH është i plotësuar me profile fasadash dhe tabela ndërtimi për mbulimin e dysHEMEVE dhe mureve.

Austroterm GmbH është pjesë e Schmid Industrieholding GmbH, Austri (*Schmid Industrieholding GmbH*), ("SHIH"). Nëpërmjet shoqërive të saj të lidhura, SHIH është aktive në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë nxjerrjen e lëndëve të para (kryesisht nxjerrjen e gëlqeres, talc); prodhimin e çimentos; materiale për industrinë e ndërtimit (siç janë bojërat, produkte montimi, veshje, llaç, izolim, stucco, mbushës, tulla, çimento, industria e betonit); tregti, furra për magazinim, industria e reklamës dhe pajisjet për gjueti.

SHIH ka një filial të regjistruar në Maqedoninë e Veriut, BAUMIT SHPKNJP Shkup, me seli në Jadranska Magistrala 165, Shkup, Maqedonia e Veriut, me aktivitet kryesor 46.73 – tregti me shumicë të drurëve, materialeve ndërtimore dhe pajisjeve sanitare.

Bruça Gesellschaft m.b.H. është një biznes familjar austriak që prodhon materiale izolimi me cilësi të lartë për objekte industriale dhe komerciale. Fokusimi i tij është në panelet izolimi për një gamë të gjerë aplikimesh (mure, fasada, çati), dhoma për ftohje dhe dyer për ftohje. Bruça Gesellschaft m.b.H. gjithashtu prodhon një sasi të vogël të paneleve izolimi nga polistireni i zgjeruar në lokacionin e saj në Mishelhausen, Austrinë e Poshtme. Më 30 Prill 2024, Bruça Gesellschaft m.b.H. ka përfunduar procedurat e saj të ristrukturimit të debitorit të falimentimit të hapura në fillim të vitit në Gjykatën Rajonale në Sent Pelten me një plan ristrukturimi. Si pjesë e këtij plani, Bruça Gesellschaft m.b.H. po ristrukturohet për t'u fokusuar në "aktivitetin e saj kryesor", pra, panelet izolimi, dhomat e ftohjes dhe dyert për ftohje në të ardhmen.

Bruça Gesellschaft m.b.H. nuk ka ndërmarrje-bijë, aktivitete apo të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Mjetet e synuara përbëjnë të gjithë pasurinë e Bruça Gesellschaft m.b.H. të destinuar për punën me polistirenin e zgjeruar ("EPS") në lokacionin e Mishelhausen.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска